

VENDIM
Nr. 191, datë 13.3.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 150, DATË 22.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË TRAJTIMIT
TË KONCESIONEVE (ATRAKO)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

Në vendimin nr. 150, datë 22.3.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalët “... person juridik, publik ...” zëvendësohen “... institucion buxhetor ...”.

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Shuma që do të paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), shpallet në dokumentet e garës dhe paguhet nga koncesionari fitues, si më poshtë vijon:

a) Për projektet koncesionare deri në 5 000 000 (pesë milionë) euro, shuma e pagueshme është 5 000 (pesë mijë) euro.

b) Për projektet koncesionare mbi 5 000 000 (pesë milionë) euro deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 10 000 (dhjetë mijë) euro.

c) Për projektet koncesionare mbi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 20 000 (njëzet mijë) euro.

ç) Për projektet koncesionare mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 30 000 (tridhjetë mijë) euro.”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Të ardhurat e përfituara sipas pikës 7 të këtij vendimi, derdhen në buxhetin e shtetit.”.

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), financohet nga buxheti i shtetit. Buxheti i ATRAKO-s miratohet me buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si zë i veçantë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij nga data 22.3.2009 e në vijim.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha